

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. L., nga ..., të cilin e përfaqëson me autorizim M. F., avokat në .., kundër të paditurës P. e P. Z.(PPZ) ‘‘HSB’’ në .., (ish ...), Komuna e ..., të cilën me autorizim e përfaqëson S. M., avokate në ..., dhe Sh. Z., nga ..., për shkak të kompensimit të dëmit për lëndim në punë, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 1255/2014 datë 16.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.2.2019, merr këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër pjesës I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 1255/2014 datë 16.10.2018.

Pjesa II e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 1255/2014 datë 16.10.2018, është ndryshuar pjesa I e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, C. nr. 17/2010 datë 21.11.2013, në pjesën që i referohet dëmit jo material për paditësin në shumat e gjykuara, ashtu që paditësit B. L., për dhimbje fizike i është gjykuar shuma prej 4.050 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 30% shuma prej 8.100 €, për shëmtim të shkallës së mesme shuma prej 7.200 €, të gjitha këto me kamatë vonesë ligjore nga data 6.9.2013, e deri në pagesën definitive, sipas normës së kamatës të cilën e paguajnë bankat që afarojnë në Kosovë, për mjetet e deponuara në afat më të gjatë se një

vit, pa destinim të caktuar, të cilat detyrohet e paditura t'ia paguaj paditësit në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kanosjen e përmbarimit me dhunë, ndërsa refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit mbi shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë. Me pjesën II të dispozitivit ka mbetur i pashqyrtuar paragrafi III i dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, në pjesën ku është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për pagesën e rentës mujore nga 60 € në muaj, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për këtë, sikurse edhe në pjesën ku është vendosur për kërkesën aksesore të paditësit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës kontestimore.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovtojë revizionin, t'i prishë aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi si punëtor i të paditurës i pranuar në vendin e punës si saldues – radiator gypor, më datë 27.4.2009 duke punuar në makinën për përpunimin e dërrasave pëson plagë konfasante (të dërrmishur) të gishtit të parë, të dytë, të tret, të katërt, të pestë të dorës së djathtë, me defekt – mungesë të ashtit të gishtit të dytë, tret, katërt, pestë të dorës së djathtë, të cilat lëndime nga ana e ekspertëve mjekësor janë vlerësuar si lëndime të rënda trupore me pasoja, që si pasojë tek paditësi kanë shkaktuar dhimbje fizike, zvogëlim të aktivitetit jetësor 30% dhe shëmtim trupor i shkallës së mesme.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se lartësia e aprovuar në

emër të shpërblimit të dëmit jo material e material, është shpërblim real dhe objektiv, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë, pjesërisht ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ashtu që ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar në pjesën e cila ka të bëjë me dhimbjet fizike trupore, zvogëlimin e aktivitetit jetësor, shëmtimin trupor dhe kamatën, ndërsa për pjesën tjetër të aktgjykimit, ankesën e ka refuzuar si të pabazuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, drejt i kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtës materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vendosur kur të paditurën ka obliguar që paditësit t'ia paguajë shumat e cekura si në dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar, për dhimbjet fizike shumë prej 4.050 €, për zvogëlimin e aktivitetit jetësor shumë prej 8.100 € dhe për shëmtim trupor të shkallës së mesme shumë prej 7.200 €. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, shumat e gjykuara në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jo material lidhur me shkallën e intensitetit, kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, zvogëlimin e aktivitetit jetësor dhe shëmtimin trupor. Vërtetimi i shpërblimit për dëmin jo material përfaqëson zbatim të drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykatat sipas nenit 200 të LMD duhet të kujdesen për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimin të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për faktin që synimet e tilla të jenë të pajtueshme me natyrën dhe qëllimin shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë ligjore, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditësit, shkallën e intensitetit, kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, zvogëlimin e aftësisë jetësore dhe shëmtimin trupor, sipas gjendjes së vërtetuar me anë të ekspertizës së ekspertes së ortopedisë- traumatologjisë Dr. V. B., e duke pasur parasysh edhe standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës, por edhe praktikën e deritanishme të gjykatave të Kosovës, shumat e cekura të shpërblimit të dëmit jo material të paditësit, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, janë adekuate dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas dispozitës së cekur.

Pretendimi i revizionit se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitës së nenit 182.2 pika (n) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është i pabazuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i qartë, nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe përmban arsye të mjaftueshme për gjykim të drejtë e të ligjshëm. Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, pretendimin e cekur në revizion, se nuk është vërtetuar përgjegjësia e të paditurës lidhur me lëndimin e paditësit në punë dhe gjykata nuk ka vërtetuar rrethanat e ndodhjes së lëndimit të paditësit, e vlerësoi si të pabazuar, ngase eksperti për mbrojtje dhe siguri në punë Doc.Dr.Ing. H. N., ka konkluduar se punëdhënësi ka qenë i obliguar të organizojë dhe të ndërmarrë masa të nevojshme për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe ambientit të punës, përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, trajnimeve etj. , ndërsa nga shkresat e lëndës del se paditësi tek e paditura ka punuar si saldues përfaqësues dy muaj, ndërsa ditën kritike ka punuar në makinën për gdhendjen e drurit, me ç'rast pas një kohe të shkurtër ka pësuar lëndimet e përshkruara më lartë, e cila paraqet organizim jo të mjaftueshëm të punës nga ana e punëdhënësit, që nënkupton mos aplikimin e nenit 2.2 të Ligjit nr. 2003/19 , për Siguri në Punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, për çka mban përgjegjësin primare, ndërsa ka vlerësuar se paditësi mban përgjegjësin sekondare, sepse ka pranuar të punojë në vend pune ku nuk ka qenë i caktuar me marrëveshje apo urdhër me shkrim nga drejtori dhe nuk ka qenë i trajnuar për atë vend pune. Eksperti i cekur sipas kërkesës së përfaqësueses të paditurës ka dhënë sqarim në shqyrtimin kryesor, pas së cilës përfaqësueset e të paditurës kanë dhënë vërejtjet e tyre lidhur me ekspertizën por nuk kanë kërkuar nxjerrjen e ndonjë ekspertize tjetër. Andaj, pretendimi i cekur në revizion se deri të lëndimi i paditësit ka ardhur vetëm për shkak të pakujdesisë së paditësit, nga kjo Gjykatë u vlerësua si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se gjykatat e instancës më të ulët kërkesëpadinë e paditësit e kanë aprovuar pjesërisht, ndërsa gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke përfshirë edhe zbritjen e kompensimit për kontributin e

pjesëm të paditësit në shkaktimin e dëmit, andaj pretendimet e të paditurës në këtë drejtim, u vlerësuan si të pabazuara.

Në bazë të nenit 214 par. 2 të LPK –ës revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, nuk shqyrtoi pretendimet e revizionit në këtë drejtim.

Pjesa II e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e cila ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë , përtej shumës së gjykuar, nuk është goditur me revizion dhe e njëjta nuk u shqyrtua nga kjo Gjykatë.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me nenin 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 13.2.2019, Rev.nr.37/2019

Kryetarja e Kolegjit
Emine Kaçiku